



Realizimi i fotografimit 360° të gjeoreferencuar, të rrjetit rrugor kombëtar

Me qëllim krijimin e fotografive panoramike të gjeoreferencuara të akseve rrugore kombëtare, ASIG ka përdorur teknologjinë e avancuar me kamera Street View 360° për të realizuar dhe publikuar në Gjeoportalin Kombëtar fotografimin e "Rrugëve urbane të qyteteve Lezhë dhe Shëngjin", me gjatësi prej 120 km². Gjithashtu, janë fotografuar dhe "Rrugët urbane të qytetit të Pogradecit", me një mbulim prej 60 km² rrugë me pamje 360°. Ky informacion vizual i detajuar shërben si mjet mbështetës për planifikimin territorial, menaxhimin e infrastrukturës dhe monitorimin e zhvillimeve urbane.



Rrugë Urbane – Lezhë



Rrugë Urbane – Pogradec

Publikohet Informacion Gjeohapësinor Për Temën “Rrjetet e Transportit”




ASIG ka publikuar në Gjeoportalin Kombëtar të dhënat gjeohapësinore për temën “Rrjetet e Transportit”, të cilat përfshijnë si transportin rrugor dhe transportin hekurudhor në Republikën e Shqipërisë. Dataseti përmban linjat dhe nyjet rrugore, linjat dhe nyjet hekurudhore, objektet dhe zonat e shërbimit hekurudhor si dhe elemente të tjera të infrastrukturës si ura, tunele, mbikalime dhe nënkalime.

Të dhënat e mbledhura nga Autoriteti Rrugor Shqiptar (ARRSH), Instituti i Transportit (IT) dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit (FSHZH), janë përpunuar nga ASIG përmes digjitalizimit mbi bazën e ortoimazherisë zyrtare, në përputhje me kërkesat e VKM nr. 133, datë 20.03.2019 “Standardet shtetërore për specifikimet teknike të informacionit gjeohapësinor në Shqipëri, Tema: Rrjetet e transportit”.

Zgjerimi i Hartës Bazë – Zona Trush - Barbullush

ASIG në cilësinë e Autoritetit Përgjegjës për temën “Harta Bazë”, si dhe në kuadër të zgjerimit të projektit fillestar të Hartës Bazë të shkallës 1:2000, ka vijuar me krijimin e hartës topografike digjitale për zonën rurale Trush - Barbullush në Bashkinë Shkodër. Krijimi i kësaj harte është realizuar me anë të teknologjisë së rëlevimit fotogrametrik 3D, duke mbuluar një sipërfaqe të rëlevuar prej 24.4 km². Numri i shtresave të përdorura për këto rëlevime fotogrametrike 3D arrin në 180.



Trush-Barbullush (Shkodër)

Marrëveshje Bashkëpunimi midis ASIG dhe Universitetit Bujqësor të Tiranës

Më datë, 2 qershor 2025, ASIG dhe Universiteti Bujqësor i Tiranës nënshkruan marrëveshjen e bashkëpunimit me qëllim forcimin e lidhjeve institucionale dhe zhvillimin e iniciativave të përbashkëta. Ky bashkëpunim synon rritjen e kapaciteteve njerëzore përmes përgatitjes së specialistëve të rinj në përputhje me prioritetet e zhvillimit të vendit, përmirësimin e shkëmbimit të informacionit ndërinstitutional dhe integrimin e teknologjive moderne në fushën e gjeoinformacionit.

Gjithashtu, marrëveshja mbështet lidhjen mes mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, duke krijuar mundësi të reja për inovacion dhe zhvillim të qëndrueshëm.




Rilevim me teknologjinë UAV në zonën e Lezhës

ASIG ka realizuar rilevimin fotogrametrik të zonës urbane të qytetit të Lezhës përmes përdorimit të teknologjisë UAV (Unmanned Aerial Vehicle). Ky rilevim mbuloi një sipërfaqe prej 11.85 km² me rezolucion prej 4cm, duke mundësuar prodhimin e ortofotos, modelit digjital të sipërfaqes (DSM), modelit digjital të terrenit (DTM) dhe izoipseve. Të dhënat e krijuara do të shërbejnë si bazë për planifikim urban, menaxhim territori dhe vendimmarrje të bazuar në informacion të saktë gjeohapësinor.



Ortofoto



Modeli Digjital i Sipërfaqes

Projekti SOFTMOVE: ASIG promovon teknologjitë UAS dhe zhvillimin e qyteteve inteligjente

Në kuadër të projektit SOFTMOVE, ASIG vijon angazhimin për promovimin e teknologjive të avancuara në zonën e Adriatikut Jugor, duke kontribuar në tranzicionin digjital dhe forcimin e bashkëpunimit ndërkufitar. Në këtë kuadër, ASIG ka marrë pjesë dhe ka organizuar këto aktivitete:

Takimet B2B “Përdorimi i UAS në Zhvillimin e Qyteteve Inteligjente” – Bari, Itali (3-4 qershor 2025).

Përfaqësues të ASIG prezantuan rolin e të dhënave gjeohapësinore në mbështetjen e planifikimit urban, mbrojtjes së mjedisit dhe menaxhimit të sigurisë publike, duke shkëmbyer përvoja me partnerët rajonale për zhvillimin e qëndrueshëm të qyteteve inteligjente.

Workshop “Katalizatori i Njohurive të UAS” – Tiranë, Shqipëri (19 qershor 2025).

ASIG organizoi këtë aktivitet, duke mbledhur aktorë të sektorit publik, privat dhe akademik për të trajtuar përdorimin e Sistemeve Ajrore Pa Pilot në transport, industri dhe arsim, si dhe rolin e GIS dhe inteligjencës artificiale në mbledhjen dhe analizimin e të dhënave, me synim rritjen e kapaciteteve vendase dhe nxitjen e inovacionit.



ASIG merr pjesë në workshopin “Përdorimi i GIS, RS dhe UAV në pylltari precize”



Përfaqësues të ASIG morën pjesë në workshop-in e organizuar nga Departamenti i Gjeografisë, Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, të Universitetit të Tiranës, mbi përdorimin e GIS, RS dhe UAV në pylltari precize, në kuadër të projektit kombëtar për teknologji dhe inovacion për shëndetin pyjor në Parkun Kombëtar Divjakë-Karavasta. ASIG prezantoi temën “Gjeoinformacioni për shëndetin pyjor”, duke theksuar rëndësinë e të dhënave gjeohapësinore për monitorimin e ekosistemeve dhe ruajtjen e biodiversitetit, si dhe përdorimin e teknologjive për menaxhim të qëndrueshëm mjedisor.

ASIG merr pjesë në takimin e dytë të Grupit Teknik të Koordinimit për Sistemin Kombëtar të Informacionit për Zjarret në Pyje (NFFIS).

Përfaqësues të ASIG morën pjesë më 15 qershor 2025 në takimin e dytë të Grupit Teknik të Koordinimit (TCG), i organizuar nga AKMC në bashkëpunim me JICA, në kuadër të projektit “Ndërtimi i Kapaciteteve për Sistemin Kombëtar të Informacionit për Zjarret në Pyje (NFFIS) dhe Zgjidhjeve të Bazuara në Natyrë”. Ky projekt synon të forcojë kapacitetet kombëtare për parandalimin, monitorimin dhe reagimin ndaj zjarreve në pyje, përmes krijimit të një platforme digjitale për paralajmërim të hershëm dhe raportim të standardizuar. Gjatë takimit u diskutua mbi progresin e deritanishëm, dokumentacionin teknik, metodologjinë dhe sfidat në mbledhjen e të dhënave.



BOTA E GJEONFORMACIONIT

Krijimi i partneritetit mes Konsorciumit të Binjakëve Digjitalë dhe Geospatial World

Konsorciumi i Binjakëve Digjitalë (Digital Twin Consortium – DTC) dhe Geospatial World kanë formalizuar një partneritet strategjik për të avancuar integrimin e teknologjive gjeohapësinore dhe digital twin në zhvillimin e infrastrukturës. Ky bashkëpunim synon të promovojë përdorimin e Realitetit të Shtuar (Augmented Reality – AR), Realitetit Virtual (Virtual Reality – VR) dhe Inteligjencës Artificiale (Artificial Intelligence – AI) për zgjidhje inovative në menaxhimin e infrastrukturës. Marrëveshja synon të mbështesë zhvillimin e qëndrueshëm dhe vendimmarrjen e bazuar në të dhëna në sektorë të ndryshëm.

BE propozon Aktin Hapësinor për siguri dhe zhvillim të qëndrueshëm

Komisioni Evropian ka propozuar Aktin Hapësinor të Bashkimit Evropian (EU Space Act), me synim të forcojë sigurinë, qëndrueshmërinë dhe konkurrueshmërinë në sektorin hapësinor evropian. Nisma synon të krijojë një kuadër të harmonizuar për të lehtësuar aksesin në treg dhe për të mbrojtur asetet hapësinore, duke reduktuar fragmentimin e rregullave ekzistuese. Ky akt bazohet në tre shtylla: siguri për monitorimin e objekteve hapësinore, qëndrueshmëri për reduktimin e ndikimit mjedisor dhe mbetjeve, si dhe rezistencë për forcimin e sigurisë kibernetike të infrastrukturës hapësinore. Propozimi aktualisht po shqyrtohet nga strukturat përkatëse të Parlamentit dhe Këshillit Evropian.

AKTIVITETE NË VIJIM

FOSS4G EUROPE 2025

Konferenca Evropiane FOSS4G do të zhvillohet nga 14–20 korrik 2025 në Mostar, të Bosnjë-Hercegovinës. Aktiviteti do të mbledhë profesionistë, studiues dhe studentë nga fusha e gjeoinformacionit për të ndarë njohuri, përvoja dhe zgjidhje inovative në përdorimin e teknologjive të hapura për hartografi, analiza hapësinore dhe planifikim.

14 -20 Korrik 2025

www.asig.gov.al

ICSIGG 2025

Më 20 gusht 2025, në Bitolë të Maqedonisë, do të zhvillohet Konferenca Ndërkombëtare për Imazherinë Satelitore dhe Gjeografinë GIS. Ky aktivitet do të mbledhë profesionistë dhe studiues nga e gjithë bota për të shkëmbyer ide, përvoja dhe rezultate kërkimore në fushën e imazherisë satelitore dhe GIS-it duke nxitur bashkëpunimin ndërkombëtar dhe zhvillimin e teknologjive inovative për analizën dhe përdorimin e të dhënave.

20 Gusht 2025

Telefon: +355 (0)42 223 762;

EFGS 2025

Shoqata Evropiane e Gjeostatistikës organizon nga 23–25 shtator 2025, në Oslo, të Norvegjisë, Konferencën Evropiane për Gjeostatistikën dhe të Dhënat Hapësinore. Ky aktivitet synon të fuqizojë përdorimin e të dhënave hapësinore të besueshme për vendimmarrje duke prezantuar zgjidhje të avancuara në fushën e gjeostatistikës dhe analizave hapësinore.

23 - 25 Shtator 2025

www.geoportal.asig.gov.al

E-mail: info@asig.gov.al